



GRI

## ANËTARËSIMI GRI

Kompania jonë Q-lever i është bashkuar rrjetit ndërkombëtar **Global Reporting Initiative**.

Si një anëtar i rrjetit GRI ne besojmë që do të kemi mundësinë që të zhvillojmë aftësitë tona duke u përditësuar për ndryshimet në standartet e raportimit GRI, por edhe duke kontribuar dhe mbështetur misionin e GRI.

Ne besojmë që anëtarësimi pranë GRI do të na ndihmojë që të zgjerojmë rrjetin tonë të ekspertëve dhe bashkëpunëtorëve në nivel lokal dhe ndërkombëtar.

Ne vlerësojmë që certifikimi që ofrohet nga academia GRI do të jetë një ndër avantazhet tona konkurruese dhe do na mundësojë që të ndikojmë tek zhvillimi i qëndrueshëm i klientëve tanë duke vënë theksin tek rëndësia që ka nxitja e transparencës dhe zhvillimi i ekspertizës në hartimin e raporteve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Rrjeti ndërkombëtar GRI ka mbi 500 anëtarë në 35 industri dhe ka një shtrirje globale.

Rrjeti GRI drejton praktikatat më të mira në transparencë.



### Kontakt:

Tel: +355 69 37 69292  
Mail: [info@qlever.al](mailto:info@qlever.al)  
web: [www.qlever.al](http://www.qlever.al)  
Adresa: Rruga Naim Frashëri,  
Nr. 62, Tiranë

### Cili është qëllimi ynë?

Të realizojmë ndryshime pozitive dhe të qëndrueshme në ekosistemin e biznesit dhe në zhvillimin personal të të rinjve.

### Shërbimet tona:

**In Academy**  
- platformë elektronike për ofrimin e shërbimeve të trajnimit

**In Survey**  
- studime tregu dhe analiza të dhënash në sektorë të ndryshëm të ekosistemit të biznesit

**In Connect**  
- shërbime të ndërlidhjes mes të rinjve si punëkërkuar, ekspertëve tanë dhe kompanive anëtare

**In Risk**  
- menaxhimi i riskut dhe ngritja e sistemit të kontrollit të brendshëm

Si anëtarë krenarë të Akademisë GRI, qëndrueshmëria është në zemrën e gjithçkaje që bëjmë. Bashkohuni me ne dhe nxisni potencialin tuaj të plotë në rrugëtimin si sipërmarrës.

- ✓ *Manaxhimi efektiv i kostove dhe burimeve*
- ✓ *Rrjet ekspertësh të kualifikuar*
- ✓ *Anëtar i Global Reporting Initiative*

## Mjedisore. Socialë. Qeverisje.

Së bashku, ESG po i transformon bizneset në forca për mirë – duke krijuar një botë më të mirë, më të drejtë dhe më të qëndrueshme."

|| N = ESG



# IN=ESG

IN ESG është pjesë e shërbimeve që ofron kompania Q-Lever një anëtare e rrjetit Global Reporting Initiative. Agjencia e Start UP ka zgjedhur projektin tonë fitues dhe do na mbështesë në zhvillimin e platformës për trajnimet online dhe organizimin e konferencës për përfitimet që ka ekosistemi nga implementimi i praktikave të qëndrueshme. Nëpërmjet projektit IN ESG ne synojmë që të rrisin ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve lidhur me implementimin e praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm.

## VLERAT TONA

- **Mbajtja** e standardeve të larta të punës dhe infrastrukturës
- **Ruajtja** e standardeve etike
- **Manaxhimi** efektiv i kostove dhe burimeve
- **Implementimi** i praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm

# ESG



## Mjedisore (E)

Ekosistemi që ka politika mjedisore të implementuara mirë është më elastik në terma afatgjatë.



## Sociale (S)

Aftësia e organizatave për të përmbushur nevojat e punonjësve dhe komunitetit është një element që dallon bizneset e qëndrueshme.



## Qeverisja (G)

Një shoqëri që është e mirëstrukturuar dhe vepron në mënyrë të përgjegjshme ka një vlerë më të madhe në sytë e investitorëve dhe financuesve.

## SYNIMI JONË

Synimi jonë është t'i ofrojmë komunitetit të biznesit teknikat dhe mjetet për implementimin dhe raportimin e praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm të cilat shkojnë në harmoni me manaxhimin efektiv financiar të biznesit. Po ashtu ne synojmë që të ndërveprojmë me akademinë për nxitjen e kërkimit shkencor dhe shkollat e formimit profesional për edukimin dhe nxitjen e praktikave Green. Një component i rëndësishëm është edhe komunikimi me institucionet publike lidhur me përfshirjen e praktikave të qëndrueshme në politikëbërje.

## Cili është misioni ynë?

Të ndihmojmë klientët tanë që të realizojnë përmirësime të qënësishme në performancën e tyre financiare, të zhvillojmë praktika që mundësojnë zhvillimin dhe trajnimin e të rinjve dhe të krijojmë rrjetëzim harmonik të aktorëve të biznesit, akademisë dhe



**Përmirësime**  
*Financiare*



**Zhvillim**  
*Praktikash*



**Trajnime**  
*Profesionale*



**Rrjetëzim**  
*Harmonik*

**MISIONI**

